

Disa nga të vranët në Kumanovë janë ekzekutuar pasi që janë dorëzuar tek policia maqedonase. Burimet e sigurta të Tribuna Channel brenda Departamentit të Mjekësisë Ligjore në Prishtinë kanë thënë se në trupat e disa nga nëntë të vranëve në Kumanovë janë gjetur edhe plumba e gëzhoja granatash.

“Në bazë të gjetjeve vërtetohet se disa nga të vranët janë ekzekutuar pasi që janë dorëzuar autoriteteve maqedonase. Kjo është vërtetuar në bazë të përcaktimit të kohës së vdekjes. Ndoshta janë bërë lëshime, ndoshta edhe nuk i kanë pasur mjetet e nevojshme për të bërë autopsinë”, kanë thënë burimet e Tribuna Channel brenda Departamentit të Mjekësisë Ligjore në Prishtinë.

Po sipas këtyre burimeve, trupat e të vranëve kanë qenë tejte të dëmtuar.

Edhe Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut përmes një komunikate për media kishte thënë se dyshon se disa nga nëntë shtetasit kosovarë, të vranë në konfliktin në Kumanovë, janë vranë pasi janë dorëzuar.

Të dielën pasdite është bërë varrimi i Beg Rizajt në kompleksin memorial të Glllogjanit, ndërsa, organizatat e dala nga Lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, kanë vendosur që tetë të vranët e tjerë të varrosen në varrezat e Dëshmorëve të Kombit në Prishtinë, ditën e martë.

Në konfliktin e armatosur të ndodhur në Kumanovë janë vranë 18 persona, prej të cilëve 8 policë dhe 10 nga grupi i armatosur. Nëntë nga të vranët janë nga Kosova, trupat e të cilëve u sollën nga Maqedonia mëngjesin e së premtes. /Tribuna Channel/